REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT- VENDIM

Nr.131 Datë 31.12.2025

" PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PJESSHËM TË DESTINACIONIT PËR SIPËRFAQEN 1347 M² , PJESË E PASURISË 17/322/1 ZONA KADASTRALE 8641 "TRUALL" NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË , DUKE SHTUAR FUSHËN E PËRDORIMIT DHE ARSIMIN PARASHKOLLOR "

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nënpika 1.1, shkronja "a" "c", nenin 23, pika 11, nenin 54, nenin 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" të ndryshuar; ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.46 datë 16.01.2008 " Për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë , të pronës e cila është në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëtor, dhe disa ndryshime të Vendimin nr.60 datë 1.02.2006 të Këshillit të Ministrave për listës së inventarit të pronave shtëtërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi shërbimit social shtetëtor" me anë të cilës është transferuar në pronësi të Bashkisë Sarandë godina e "Qendra e Shërbimeve për femijër 6-14 vjeç", Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Juridike :

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të pjesshëm të destinacionit për sipërfaqen e truallit prej 1347 *(njëmijë e treqind e dyzet e shtatë)* m^2 , pjesë e pasurisë pasurinë nr.17/322/1 Zona Kadastrale 8641 *(me sipërfaqe totale 3300 m 2)* aktualisht me funksion" Shtëpia e Fëmijës 6-14 vjeç" pasuri në pronësi të Bashkisë Sarandë, duke shtuar fushën e përdorimit të saj dhe "*arsimin parashkollor"* .
2. Pjesa e pasurisë e llojit truall me destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi individualizohet në planvendosjen bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Bashkia Sarandë të marrë të gjithë masat e nevojshme për vijimin dhe ndjekjen e procedurës administrative për ndryshimin e destinacionit referuar parashikimeve ligjore në fuqi.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian Drejtoria Juridike , dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Florjan SALI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SARANDË